

Data: 27.07.2023

Vendi: Akademia Tempulli


Takimi i komitetit të programeve me këtë

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Vijueshmëria e studentëve semestrin veror,
3. Kalueshmëria e studentëve ne afatin e Prillit dhe Qershorit,
4. Mbarëvajtja e procesit mësimorë,
5. Analiza e kërkesave nga takimi me këshillin e partneritetit për rishikimin e programeve studimore te Akademisë për riakreditim,
6. Diskutimi i raporteve të sigurimit të cilësisë,
7. Përdorimi aktiv i Moodle dhe SEMS, (vonesa e rezultateve)
8. Vizitat studimore, ligjërues mysafir,
9. Caktimi i komisioneve të temave të diplomës dhe
10. Të tjera.

Mbledhja do të mbahet me datën 27 Korrik 2023 në orën 10.00.

Koordinatorët:

Dr.Sc.  Bixhaku dhe Msc. Adem Selmani

Nga mbledhja e Komiteti të programit të mbajtur me datë 27.07.2023, në Akademi duke filluar prej orës 10:00.

Prezentë:

1. Dr.Sc. Mevlan Bixhaku Koordinator i programit master,
2. Msc. Adem Selmani, Koordinator i programit bachelor,
3. Dr. Sc. Muhamed Krasniqi, staf akademik, drejtor ekzekutiv,
4. Dr.Sc. Astrit Sallauka, staf akademik,
5. Dr.Sc.Habib Hasani, staf akademik,
6. Dr.Sc. Flamur Salihu, këshilltar I jashtëm,
7. Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi, staf akademik,
8. Msc. Gezim Krasniqi, staf akademik,
9. Msc. Shpresa Ibrahim, staf akademik,
10. MSc. Sami Mazreku, staf akademik,
11. Dr.Sc. Eflorim Hajra, staf akademik,
12. Dr.Sc. Naser Lajqi, staf akademik,
13. Dr.Sc. Shpetim Lajqi, staf akademik,
14. Msc. Fatime Krasniqi Sekretarja e Përgjithshme e Akademisë,
15. Arsim Zagragja, nga rendi studentor
16. Nazmi Gashi, nga rendi studentor,
17. Blerina Dragusha, asistente administrative.

Mbledhjen e hapi Koordinatorin Dr.Sc.Mevlan Bixhaku i cili i falënderoi për prezencën dhe propozoi për miratim këtë:

REND DITE

- I. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- II. Vijueshmëria e studentëve semestrin veror,

- III. Kalueshmëria e studentëve ne afatin e Prillit dhe Qershorit,
- IV. Mbarëvajtja e procesit mësimorë,
- V. Analiza e kërkesave nga takimi me këshillin e partneritetit për rishikimin e programeve studimore te Akademisë për riakreditim,
- VI. Diskutimi i raporteve të sigurimit të cilësisë,
- VII. Përdorimi aktiv i Moodle dhe SEMS, (vonesa e rezultateve)
- VIII. Vizitat studimore, ligjërues mysafir,
- IX. Caktimi i komisioneve të temave të diplomës dhe
- X. Të tjera.

Rendi I ditës u aprovua unanimisht nga të gjithë pjesëmarrësit e Komiteti të Programit.

I. Miratimi i ekstraktit nga mbledhja e kaluar

Në mënyrë unanime u aprovua ekstrakti nga mbledhja e kaluar dhe nuk pat ndonjë sygjërim apo ndryshim.

II. Vijueshmëria e studentëve semestrin veror,

Adem Selmani në cilësinë e Koordinatorit për studime bachelor i prezantoi të dhënat e vijueshmërisë për nivelin bachelor, ku statistikat nuk janë të kënaqshme, sepse prej 51 studentëve, mesatarisht 9 studentë kanë qenë të rregullt në ligjërata.

Mevlan Bixhaku, në cilësinë e Koordinatorit për studime Master, i tregoi statistikat e vijueshmërisë ku në nivelin master vijueshmëria është në nivel më të kënaqshëm.

Shresa Ibrahim i nga stafi akademik propozoi që të bëhet një krahasim në mes vijueshmërisë dhe numrit të personave që paraqesin provimet dhe të krahasohen kalueshmëria në mënyrë që të gjendet shkaktari.

Gezim Krasniqi theksoi se angazhimet e punës së studentëve janë ndër shkaktarët kryesor të mungesës në ligjërata.

Prof. Sami Mazreku theksoi se Institucioni ka infrastrukturë, mjete të gjitha për mbarëvajtje të suksesshme të ligjëratave, por ka mungesë interesimi nga ana e studenteve. Po ashtu theksoi se ka mungesë interesimi nga ana e studentëve edhe për vizita studimore dhe angazhime shtesë. Njëherësh theksoi se duhet krahasuar suksesi i studentit që vjen në ligjërata më atë që nuk vjen.

Prof. Naser Lajqi theksoi se duhet të bëhet një plan konkret I përmirësimit të vijueshmërisë dhe plan I përmirësimit dhe duhet te merret një vendim institucional se çka te bëhet me nxitjen e vijueshmërisë më së largu deri në shtator. Mundësia Hybride (online dhe ne klase) mund të jetë një veprim I duhur.

Prof. Shpëtim theksoi një problematikë, që është kopjimi dhe duhet hapa konkret që ky fenomen të dënohet dhe studentët të shkojnë në procedura disiplinore.

III. Kalueshmëria e studentëve ne afatin e Prillit dhe Qershorit,

Koordinatorët e programeve i prezantuan statistikat e kalueshmërisë për secilën lëndë në Afat të Qershorit dhe Prillit.

Në përgjithësi kalueshmëria është brenda normave të kënaqshme. Por, nota mesatare e përgjithshme është e ulët. Indikator që tregon se vlerësimi ka qenë real, por duhet plan konkret i përmirësimit të nivelit të të nxënit në mënyrë që të ngritët gradualisht edhe nota e vlerësimit. U ritheksua kopjimi si fenomen shqetësues dhe do të adresohen hapa konkret ne parandalim.

IV. Mbarëvajtja e procesit mësimorë,

Prof. Mevlan Bixhaku, koordinator I programit Master thekson se vijueshmëria e procesit mësimor në programin Master ka qenë në rregull, por problematikë e vazhdueshme vazhdon të jetë ndryshimi I orarit nga ana e studentëve.

Prof. Adem Selmani, koordinator I studimeve bachelor theksoi se mbarëvajtja ka qenë në rregull dhe e kënaqshme, me përjashtim të ndonjë rasti individual.

V. Analiza e kërkesave nga takimi me këshillin e partneritetit për rishikimin e programeve studimore te Akademisë për riakreditim

Koordinatorët njoftuam për takimin e mbajtur me këshillin e partnerëve dhe i shpalosën sugjerimet e tyre në rishikim të programeve.

Kërkesat e industrisë janë që të integrohet komponenti SMART si pjesë e lëndëve, Studentët me qenë pjesë e punës praktike, dhe synimi është që studentët të mbesim në punë në kompani.

Si rezultat i kësaj në syllabuset tona duhet të jetë patjetër e integruar praktika, dhe aty ku ka mundësi deri ne masën 40% por duke pas parasysh mbikëqyrjen, duhet të punohet në një plan konkret të mbikëqyrjes. Po ashtu, u sugjerua që të bëhen sa më shumë formalizme të MoU me biznese ku studentët do të kenë mundësi të përfundojnë pjesën praktike.

VI. Diskutimi i raporteve të sigurimit te cilësisë,

Koordinatorët e programit i diskutuam rezultatet e vlerësimit, të cilat i prezantuan dhe të njëjtat i kanë pranuar përmes email stafi akademik, dhe vlerësuan se rezultatet janë të kënaqshme dhe të pranueshme, me një mesatare mbi 3.5 të shkallës Likert. Po ashtu, kërkuan bashkëpunim më të madh të stafit akademik në ngritje të vazhdueshme të cilësisë dhe synimi është që vitet e ardhshme vlerësimet të jenë mbi notën 4.

Po ashtu, u kërkua që të përfundohen plani i përmirësimit bashkërisht me koordinatorët, si mjet i duhur për reflektim.

U cek që vlerësimet janë bërë për SEMS dhe Google Form, the janë inkurajuar pjesëmarrje sa më e madhe e studentëve.

Po ashtu u përmend edhe vlerësimi i bërë për institucionin nga ana e stafit akademik, ku rezultatet janë dërguar në menaxhment për reflektim të mëtutjeshëm.

VII. Përdorimi aktiv i Moodle dhe SEMS, (vonesa e rezultateve)

Koordinatorët i kërkuan nga stafi akademik që të përdorin në mënyrë më interaktive MOODLE dhe rezultatet e testimeve dhe vlerësimeve të mos vonohen më shumë se 7 ditë punë, gjët për të cilën u dakorduan të gjithë.

Prof. Naser shtoj që kjo do të jetë e pamundur në rastet me punime seminarike, por do të mundohen brenda afateve më të shpejta ti përfundojnë.

VIII. Vizitat studimore, ligjërues mysafir,

Më kërkesë të studentëve, u kërkua nga stafi akademik të të paktën brenda semestrit, të kenë një mysafir special në ligjëratë dhe një vizitë studimorë në kompani.

Të gjithë u dakorduan.

XI. Caktimi i komisioneve të temave të diplomës

U caktuan komisionet për vlerësimin teknik të temave të diplomës, ku u propozuan të jenë pjesë e komisioneve:

Msc. Sara Fusha Osmani

Dr. Sc. Mevlan Bixhaku dhe

Dr. Sc. Ema Berisha Krasniqi.

Të gjithë u pajtuan në mënyrë unanime për komision, ku këta anëtarë do të dërgohen në këshill akademik për aprovim.

Diskutime tjera nuk kishte dhe mbledhja përfundoj në ora 11:30.

Adem Selman, Koordinator i programit Bachelor

Adem Selmani

Mevlan Bixhaku, Koordinator i programit Master

Mevlan Bixhaku
